

PROCES VERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4km) si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë” (Kontratë me çelësa në dorë),

Punë ndërtimi - 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,500,000,000 **Leke** (njëmiliard e pesëqindmilion) pa tvsh.

Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë se dates 08.05.2026 kjo vlerë konvertohet **15,716,680** (pesëmbëdhjetëmilion e shtatëqind e gjashtembedhjetemijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) **Euro pa TVSH** .

**Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 08.05.2026 është 95.44 Lekë/Euro.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 (ndryshuar me ligjin nr.16/2024, datë 08.02.2024) “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024) autoriteti/enti kontraktor ”Hekurudha Shqiptare sh.a” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 79, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik *(ndryshuar me*

Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaramit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare, konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është e bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin, 43 pika 2 gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021(ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024) “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare: (2023, 2024, 2025), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akti Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet

kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 2,3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh

ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

1. PROJEKTIM URBANIST

c- Plane të detajuara vendore

Argumentim:

Duke u bazuar në:

- VKM Nr. 943, datë 28.12.2016, “Për miratimin e listës së profesioneve, kritereve dhe procedurave për pajisjen me certifikatë profesionale dhe licencë në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit”;
- Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 119/2020;
- Kërkesat e ToR dhe specifikimeve teknike të projektit “Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4km) si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë”,

kërkohet që subjekti projektues të jetë i pajisur me licencën “Projektim Urbanist – C: Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore kërkon licensë për projektim urbanistik pasi ndërhyrja prek drejtpërdrejt territorin urban, infrastrukturën ekzistuese dhe hapësirat publike. Projekti duhet të jetë i koordinuar me planet urbane, rrjetin rrugor, shërbimet publike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit të Tiranës. Licensa garanton që projekti hartohet dhe zbatohet nga specialistë të kualifikuar, duke respektuar standardet teknike, ligjore dhe mjedisore, si dhe duke siguruar sigurinë dhe funksionalitetin afatgjatë të infrastrukturës hekurudhore.

2. PROJEKTUES ARKITEKT

3. Objekte spitalore; terminallet ne infrastrukture; vepra arti ne infrastrukture

Argumentim:

Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë, kërkon licensë për Projektues Arkitekt, pasi projekti përfshin jo vetëm infrastrukturën hekurudhore, por edhe projektimin arkitekturor të objekteve shoqëruese dhe funksionale. Këto përfshijnë:

- stacionet e trenit,
- терминаlet e transportit publik,
- objektet teknike,
- hapësirat e pritjes,
- shërbimet për pasagjerët,
- arkitekturore
- vepra arti të integruara në infrastrukture.

Projektimi arkitekturor është i domosdoshëm për të garantuar funksionalitetin, sigurinë, aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, si dhe përshtatjen e objekteve me mjedisin urban përreth. Për më tepër, projekti duhet të respektojë standardet arkitekturore, teknike, ligjore dhe mjedisore, duke siguruar cilësi ndërtimi dhe qëndrueshmëri afatgjatë. Pajisja me licensë për Projektues Arkitekt garanton që hartimi dhe zbatimi i projektit kryhet nga profesionistë të kualifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e DST-së.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.*
- c-2 Troje dhe shpate dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.*
- d Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike*

Argumentim:

Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë, kërkon licensë për Projektues Konstruktor, pasi projekti përfshin vepra ndërtimore dhe struktura mbajtëse që duhet të garantojnë siguri dhe qëndrueshmëri afatgjatë. Në kuadër të këtij projekti realizohen:

- struktura prej beton-arme,
- struktura metalike dhe murature si stacionet hekurudhore,
- objektet teknike,
- platformat,
- mbikalimet,
- nënkalimet
- elemente të tjera infrastrukture.

Gjithashtu, traseja hekurudhore kalon në zona urbane dhe troje me karakteristika të ndryshme gjeoteknike, përfshirë shpate ose zona me qëndrueshmëri të ulët, ku kërkohet analizë dhe projektim konstruktiv i specializuar.

Projektuesi konstruktor është përgjegjës për vlerësimin e kapacitetit mbajtës të strukturave ekzistuese, si dhe për projektimin e përfundimeve të nevojshme për të përballuar ngarkesat dinamike të trenit dhe kushtet sizmike.

Pajisja me licensë për Projektues Konstruktor garanton që projekti hartohet dhe zbatohet nga profesionistë të kualifikuar, në përputhje me standardet teknike, normat e sigurisë dhe legjislacionin në fuqi, duke siguruar funksionim të sigurt dhe jetëgjatësi të infrastrukturës hekurudhore.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- b. Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.*
- c. Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.*
- d. Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit.*
- f. Projektim të sistemeve kundra zjarrit.*
- g. Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.*
- i. Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj*
- j. Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industrial*

Argumentim:

Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë, kërkon licensë për Projektues Instalator, pasi projekti përfshin projektimin dhe koordinimin e një sërë sistemesh teknike dhe instalimesh komplekse, të domosdoshme për funksionimin e sigurt dhe efikas të infrastrukturës hekurudhore. Këto përfshijnë:

- instalimet elektrike,
- sistemet e ndriçimit rrugor dhe të stacioneve,
- instalimet termoteknike
- instalimet e kondicionimit në objektet e shërbimit dhe terminale,
- impiantet e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme.

Gjithashtu, projekti kërkon:

- projektimin e sistemeve të telekomunikacionit,
- rrjeteve të telefonisë,

- rrjetin e internetit dhe CCTV,
- rrjetin e kontrollit të aksesit dhe sistemeve të monitorimit dhe automatizimit për menaxhimin e trafikut hekurudhor dhe sigurinë e pasagjerëve.

Si dhe gjithashtu me te rendesishme:

- sistemi kundër zjarrit
- sistemet e alarmit,

të cilat janë thelbësore për mbrojtjen e jetës dhe pasurisë në stacione, terminale dhe objekte teknike.

Pajisja me licensë për Projektues Instalator garanton që këto sisteme projektohen nga profesionistë të kualifikuar, në përputhje me standardet teknike, normat e sigurisë dhe legjislacionin në fuqi, duke siguruar funksionim të integruar, të sigurt dhe të qëndrueshëm të linjës hekurudhore dhe objekteve shoqëruese.

5. PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE

b. Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.

c. Ujësjellës-kanalizime urbane – rurale.

d. Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.

Argumentim:

Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë, kërkon licensë për Projektues Vepra Hidraulike, pasi traseja hekurudhore ndërvepron drejtpërdrejt me rrjetet ekzistuese të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve urbane, si dhe me sistemet e kullimit të ujërave sipërfaqësore. Projekti përfshin projektimin e:

- kolektorëve shkarkues
- furnizim me ujë dhe kanalizimeve
- veprave të drenazimit për të garantuar mbrojtjen e linjës hekurudhore nga përmytjet dhe dëmtimet nga uji.

Gjithashtu, gjatë zbatimit të projektit realizohen vepra hidraulike si:

- tombino,
- sifona,
- damba,
- kapërderdhëse

- struktura të tjera kullimi

të domosdoshme për kalimin e sigurt të ujërave në zonat urbane dhe përgjatë trasës hekurudhore. Projektimi korrekt i këtyre veprave është thelbësor për qëndrueshmërinë e infrastrukturës, mbrojtjen e mjedisit dhe funksionimin normal të sistemeve ujore ekzistuese.

Pajisja me licensë për Projektues Vepra Hidraulike garanton që këto ndërhyrje projektohen nga specialistë të kualifikuar, në përputhje me standardet teknike, kushtet hidrologjike dhe legjislacionin në fuqi, duke siguruar funksionim të sigurt dhe afatgjatë të linjës hekurudhore.

6. PROJEKTUES RRUGE – HEKURUDHA

a. Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

e. Hekurudha - degëzime hekurudhore.

Argumentim:

Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë, kërkon licensë për Projektues Rrugë – Hekurudha, pasi projekti përfshin projektimin e plotë të infrastrukturës hekurudhore dhe ndërveprimin e saj me rrjetin rrugor ekzistues. Projektimi përfshin:

- përcaktimin e trasës hekurudhore,
- elementet gjeometrike,
- shtresat mbajtëse,
- sistemet e kullimit
- dhe elementet e sigurisë së linjës, në përputhje me standardet teknike për hekurudhat.

Gjithashtu, projekti përfshin:

- projektimin dhe rregullimin e rrugëve lokale,
- rrugëve urbane dytësore dhe
- rrugëve interurbane dytësore që ndërveprojnë me linjën hekurudhore,
- si dhe krijimin e rrugëve dytësore ndihmëse për akses në stacione, terminale, objekte teknike dhe mirëmbajtje të infrastrukturës.

Këto rrugë janë të domosdoshme për funksionimin normal të linjës, qarkullimin e shërbimeve emergjente dhe menaxhimin e trafikut gjatë dhe pas ndërtimit.

Pajisja me licensë për Projektues Rrugë – Hekurudha garanton që projekti hartohet dhe zbatohet nga profesionistë të kualifikuar, duke respektuar normat teknike, kushtet urbane dhe legjislacionin në fuqi, si dhe duke siguruar siguri, funksionalitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë të linjës hekurudhore dhe infrastrukturës rrugore shoqëruese.

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

- a. *Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.*
- d. *Ura metalike.*

Argumentim:

Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës Durrës–Tiranë, kërkon licensë për Projektim Ura dhe Vepra Arti, pasi projekti përfshin ndërtimin dhe integrimin e një sërë veprash infrastrukturore që janë thelbësore për funksionimin e sigurt dhe efikas të linjës hekurudhore. Këto përfshijnë:

- Ura të vogla deri në 10 m;
- Ura metalike;
- Mbikalime dhe nënkalime për rrugë lokale dhe dytësore;
- Kaskada, kapërderdhëse dhe sifona për kalimin e ujërave sipërfaqësorë;
- Vepra arti të tjera të lidhura me infrastrukturën hekurudhore, si mure mbajtëse, platforma, dhe elemente të sigurisë.
- Kalime nentokesore për hekurudha me një gjatësi prej 800m

Projektimi i këtyre veprave është i domosdoshëm për të garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë strukturore të linjës hekurudhore, duke marrë parasysh ngarkesat dinamike të trenave, kushtet gjeoteknike dhe hidrologjike të zonës, si dhe ndërveprimin me rrugët, rrjetet ujore dhe objektet urbane përreth. Veprat duhet të integrohen estetikisht në peizazhin urban, të respektojnë standardet teknike dhe të sigurojnë mirëmbajtje të lehtë dhe funksionalitet afatgjatë.

Pajisja me licensë për Projektues Ura dhe Vepra Arti garanton që këto veprime projektohen dhe zbatohen nga specialistë të kualifikuar, në përputhje me standardet e sigurisë, normat ligjore dhe urbanistike, si dhe praktikat më të mira inxhinierike. Kjo siguron që linja hekurudhore të funksionojë në mënyrë të sigurt, efikase dhe të qëndrueshme për përdoruesit dhe mjedisin përreth.

8. *PROJEKTUES GJEODET*

- a- *Rivelime inxhinierike.*
- b- *Rilevime inxhinierike kadastrale.*
- e. *Projektim fotogrametrik dhe hartografik.*

Argumentim:

Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës Durrës–Tiranë, kërkon licensë për Projektues Gjeodet, pasi realizimi i projektit mbështetet në një sërë veprimtarish gjeodezike dhe hartografike të detajuara, të domosdoshme për sigurinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e linjës hekurudhore.

Këto aktivitete përfshijnë:

- **Rivelime inxhinierike** për përcaktimin e trasës së saktë, nivelimin e terrenit, pozicionimin e objekteve infrastrukturore dhe elementeve teknike;
- **Rivelime inxhinierike kadastrale** për identifikimin e kufijve të pronave dhe për sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin mbi pronësinë, duke shmangur konfliktet gjatë ndërtimit dhe përdorimit të linjës;
- **Projektim fotogrametrik dhe hartografik** për dokumentimin e terrenit dhe infrastrukturës ekzistuese, planifikimin urban, koordinimin me rrugët dhe rrjetet e tjera infrastrukturore, si dhe për monitorimin e avancimit të punimeve gjatë ndërtimit.

Gjithashtu, gjeodeti ka rol të vazhdueshëm gjatë gjithë fazës së ndërtimit, duke siguruar saktësi në vendosjen e elementeve kritike, kontrollin e nivelimit, verifikimin e gjeometrisë së trasës dhe monitorimin e ndryshimeve të mundshme të terrenit. Këto veprime janë të domosdoshme për qëndrueshmërinë, sigurinë dhe efikasitetin e linjës hekurudhore dhe për minimizimin e rreziqeve në zbatim.

Pajisja me licensë për Projektues Gjeodet garanton që të gjitha këto aktivitete kryhen nga profesionistë të kualifikuar, në përputhje me standardet teknike, normat ligjore dhe kërkesat e DST-së, duke siguruar saktësi, cilësi dhe integritet ligjor të të dhënave gjeodezike. Kjo kontribuon në realizimin e një linje hekurudhore funksionale, të sigurt dhe të qëndrueshme, e cila është e integruar harmonikisht në mjedisin urban dhe natyror përreth.

9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.*
- d- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.*
- e.- Studime e projekttime hidrogjeologjike.*

Argumentim:

Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës Durrës–Tiranë, kërkon licensë për **Studim Gjeologo-Inxhinierik dhe Hidrogjeologjik**, pasi realizimi i projektit mbështetet drejtpërdrejt në karakteristikat e terrenit, të trojeve dhe shpateve, si dhe në kushtet hidrogjeologjike dhe hidrogjeologjike të zonës.

Ky studim ka një rol kritik për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e linjës hekurudhore, pasi përfshin:

1. **Studim dhe vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit dhe substratit** për zonat ku ndërtohen stacionet, platforma, objektet shoqëruese dhe elementet infrastrukturore, duke siguruar që ndërtimi të bëhet mbi bazë të kushteve reale të terrenit dhe të shmangen rrëshqitjet ose deformimet.

2. **Analizë e trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët**, për të identifikuar rreziqet e rrëshqitjes së dheut, për të projektuar përforcime strukturore dhe për të garantuar qëndrueshmëri afatgjatë të linjës.
3. **Studime hidrogjeologjike**, për vlerësimin e rrjedhjes së ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, ndikimin e tyre në strukturat e ndërtuara, kontrollin e përmbajtjeve dhe planifikimin e veprave të kullimit dhe drenazhit.
4. **Vlerësim i ngarkesave dhe reagimit të terrenit ndaj infrastrukturës hekurudhore**, duke përfshirë ndërveprimin me ura, mbikalime, rrugë dytësore ndihmëse dhe objekte shoqëruese.

Pajisja me licensë për Studim Gjeologo-Inxhinierik dhe Hidrogjeologjik garanton që këto analiza kryhen nga specialistë të kualifikuar, në përputhje me standardet teknike dhe normat ligjore, duke siguruar:

- Siguri maksimale për pasagjerët dhe punonjësit gjatë funksionimit të linjës;
- Qëndrueshmëri afatgjatë të infrastrukturës ndaj ndryshimeve natyrore dhe ngarkesave dinamike;
- Projektim të saktë të strukturave mbajtëse, veprave të drenazhit, rrugëve ndihmëse dhe veprave arti;
- Mbrojtje të mjedisit dhe përdorimit të qëndrueshëm të resurseve ujore dhe tokës.

Ky studim është i domosdoshëm për çdo fazë të projektit – nga planifikimi urban dhe përcaktimi i trasës, te zbatimi i ndërtimit dhe mirëmbajtja – dhe siguron që vendimet inxhinierike të bazohen në të dhëna të sakta, të vlefshme ligjërisht dhe teknologjikisht.

2.3.3 Staf i kërkuar :

Operatori ekonomik ose bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të ketë të përfshirë si drejtues teknik dhe të figurojë në Licensën e shoqërisë, stafin e mëposhtëm:

- | | |
|--------------------------|---------|
| - Projektues Arkitekt | 1 (një) |
| - Projektues Konstruktor | 1 (një) |
| - Projektues Mekanik | 1 (një) |
| - Projektues Elektrik | 1 (një) |
| - Projektues Gjeodet | 1 (një) |
| - Projektues Gjeolog | 1 (një) |
| - Projektues Hidroteknik | 1 (një) |
| - Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |

Për stafin e mësipërm duhet paraqitur për secilin dokumentacioni provues si:

- Diploma
- CV personale
- Kontrata e Punës (e vlefshme ligjërisht)
- Secili nga anëtarët e stafit të sipërcituar dhe të angazhuar, të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve për t'u realizuar objekt i kësaj kontratë në rast të shpalljes fitues.

- Staf i sipërcituar të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentim: Baza ligjore

- Ligji nr. 107/2014, i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 8402/1998, i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”;
- VKM nr. 943, datë 28.12.2016, për kriteret dhe procedurat e licencimit të profesionistëve në fushën e zhvillimit të territorit;
- Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 45, pika 1, shkronja “a”, kërkon që operatorët të demonstrojnë kapacitetet teknik dhe profesional të mjaftueshëm.

Në projektet e infrastrukturës hekurudhore si “Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës Durrës–Tiranë”, që përfshin:

- Ndërtime sipërfaqësore dhe nëntokësore
- Struktura betoni, metalike dhe ndihmëse
- Impiante elektrike, mekanike, ndriçimi, ujësjellës-kanalizime, drenazhime, etj.
- Studime të specializuara gjeologjike, gjeodezike, hidroteknike

është detyrimisht e nevojshme që projekti të hartohet nga një staf i plotë multidisiplinar, me përfaqësim profesional nga çdo fushë.

Profili i kërkuar	Arsyeja teknike
Projektues Arkitekt	Për konceptimin arkitektonik të strukturave ndihmëse, ambienteve teknike, terminaleve, etj.
Projektues Konstruktor	Për llogaritjen e sigurisë strukturore të objekteve dhe veprave arti
Projektues Mekanik	Për impiantet termoteknike, kondicionimin dhe sistemet e zjarrit
Projektues Elektrik	Për rrjetin elektrik të objekteve dhe ndriçimin rrugor
Projektues Gjeodet	Për matje, trasim dhe hartografi teknike

Profili i kërkuar	Arsyeja teknike
Projektues Gjeolog	Për studime të tokës, kapacitet mbajtës dhe shpate
Projektues Hidroteknik	Për projektimin e kanalizimeve, ujësjellësit, sistemeve të kullimit e mbrojtjes nga ujërat
Inxhinier Ndërtimi	Për hartimin e preventivave, përlllogaritjen e sasisë dhe kostos së materialeve

Perfshirja e stafit ne listë pagesat e operatorit

- Garancia e përfshirjes reale në staf – Shumë operatorë shpesh paraqesin CV fiktive. Detyrimi për të qenë në licencë + listë pagesash për të paktën 3 muaj garanton se personi është realisht i brendshëm dhe i angazhuar me përgjegjësi në projekt.
- Drejtuesi teknik është kërkuar nga vetë VKM 943 si detyrim për të ligjëruar përgjegjësinë teknike të subjektit.
- Në mungesë të stafit të brendshëm të përfshirë dhe të licencuar, projekti rrezikon mungesë cilësie, bashkërendimi teknik dhe siguri.

Pse kërkohen dokumentet shoqëruese

Diploma + CV personale	Verifikimi i kualifikimeve dhe eksperiencës së kërkuar
Kontratë pune e (vlefshme ligjerisht)	Siguron se personi është i punësuar realisht dhe me detyrime
Deklaratë disponueshmërie	Shmang përfshirjen e personelit të mbingarkuar ose me angazhime të tjera
Listë pagesash 3 mujore	Provon se personi është pjesë aktive e shoqërisë dhe jo i ftuar vetëm për aplikim

Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave (e Vërtetuar kjo me listë pagesat përkatëse, të Konfirmuar nga Drejtoria e Taimëve, sipas formularit E-Sig 02/a,)

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi: Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpriqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.4 *Operatorët ekonomikë në fushën e projektimit duhet të paraqesin prova të certifikimit nga organe të pavarura akredituese si më poshtë:*

a) Certifikatë ISO 9001:2015 të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë, dhe/ose të njëvlefshme me to që mund të garantojnë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

– **Neni 45** – *Kriteret për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë:*

“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të paraqesin **prova se disponojnë sisteme të përshtatshme të menaxhimit të cilësisë**, në përputhje me standarde europiane ose ndërkombëtare.”

VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

– **Kreu IV, Neni 53, pika 1, shkronja “c”:**

“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të demonstrojnë **zbatimin e një sistemi të menaxhimit të cilësisë**, në përputhje me standardin ISO 9001 ose të barasvlershëm.”

Ne lidhje me projektin:

-Siguria dhe cilësia e projektimit

- ISO 9001:2015 siguron që subjektet që kryejnë projektimin:
 - Zbatojnë procedura të kontrolluara për kontrollin teknik, rishikimin dhe miratimin e dokumentacionit
 - Reduktojnë rrezikun e gabimeve inxhinierike dhe moskonformitetit

- Sigurojnë gjurmueshmëri dhe auditueshmëri të gjithë procesit të projektimit

-Standard profesional i kërkuar për projekte infrastrukturore kombëtare dhe ndërkombëtare

- ISO 9001 është standard i rekomanduar për konsulentët dhe projektuesit në sektorë si transporti, energjia, ndërtimet dhe mjedisi – veçanërisht në projektet me rëndësi strategjike si ne rastin tone linjat hekurudhore.

-Kusht për pjesëmarrje në prokurim dhe vlefshmërinë kontraktore

- Subjektet pa sistem të certifikuar të cilësisë mund të skualifikohen nga procedurat e përzgjedhjes apo të konsiderohen të papërgatitura për projektet e ndërlikuara.

Posedimi i ISO 9001:2015 është një garanci objektive që ata janë në gjendje të zbatojnë procedura të standardizuara sipas kërkesave të kontratës.

b) ISO 14001:2015 “Per sistemin e menaxhimit mjedisore” (te vlefshme) ose ekuivalent ne perputhje me objekt i tenderit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në

-Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar

- **Neni 5, pika 2:**

“Subjektet publike dhe private që ushtrojnë veprimtari me ndikim në mjedis, kanë për detyrë të integrojnë parimet e mbrojtjes së mjedisit në sistemet e tyre të menaxhimit dhe vendimmarrjes.”

- **Neni 25 – Vlerësimi i ndikimit në mjedis:**

“Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin jo vetëm përgatitjen e raportit, por edhe përcaktimin e masave organizative dhe procedurave për menaxhimin e qëndrueshëm të ndikimeve mjedisore gjatë fazës së projektimit dhe zbatimit.”

Kjo përfshin kërkesën për sisteme të organizuara dhe të verifikueshme të menaxhimit mjedisor.

-Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

- **Neni 45, pika 3:**

“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik të provojë se është **në gjendje të zbatojë masa mjedisore të barasvlershme me një sistem të menaxhimit mjedisor të njohur ndërkombëtarisht**, të tilla si ISO 14001.”

-VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

- **Kreu IV, Neni 54:**

“Operatorët ekonomikë mund të kërkojnë të paraqesin **certifikata ose dëshmi për sisteme të menaxhimit mjedisor**, siç është standardi ISO 14001 ose ekuivalent.”

Ne lidhje me projektin:

-Natyra e projektit kërkon menaxhim të qëndrueshëm mjedisor

“Zbatimi i projektit të linjës hekurudhore Terminali i Transportit Publik – Stacioni i Trenit Tiranë (4 km), si zgjatim i linjës Durrës–Tiranë”:

1. **Reduktimi i ndikimit mbi mjedisin urban dhe natyror:**
 - Projekti synon të minimizojë ndërhyrjet në peizazhin urban dhe zonat natyrore përgjatë trasës, duke ruajtur hapësirat e gjelbra dhe elementet ekzistuese mjedisore.
2. **Menaxhimi i ujërave dhe mbrojtja e resurseve hidrologjike:**
 - Integrimi i sistemeve të drenazhit, kapërderdhëseve dhe sifonave për të parandaluar përmytjet dhe ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
3. **Reduktimi i ndotjes së ajrit dhe zhurmës:**
 - Zbatimi i standardeve të qarkullimit hekurudhor për të ulur emetimet e ndotësve dhe ndotjen akustike, sidomos në zonat urbane pranë stacioneve dhe lagjeve banimi.
4. **Menaxhimi i materialeve dhe mbetjeve të ndërtimit:**
 - Planifikimi i riciklimit dhe trajtimit të materialeve ndërtimore për të minimizuar gjenerimin e mbetjeve dhe ndikimin në ambient.
5. **Rritja e efikasitetit energjetik dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme:**
 - Projektimi i impianteve të energjisë termike dhe sistemeve elektrike me eficiencë të lartë, duke reduktuar konsumin e energjisë dhe emetimet karbonike.
6. **Rritja e qëndrueshmërisë afatgjatë:**
 - Zbatimi i masave parandaluese dhe sistemeve monitoruese për të garantuar që infrastruktura hekurudhore funksionon në mënyrë të qëndrueshme pa dëmtime mjedisore në periudha afatgjata.
7. **Integrimi me planifikimin urban dhe komunitetin:**
 - Projektimi i linjës dhe stacioneve duke marrë parasysh ndikimin mbi komunitetin dhe duke siguruar përdorim të qëndrueshëm të hapësirave publike dhe rrugëve ndihmëse.

ISO 14001:2015 është standardi ndërkombëtar për organizimin dhe monitorimin e detyrave mjedisore gjatë projektimit dhe zbatimit të projekteve.

-Siguron që subjekti projektues ka kapacitete të strukturuar për të:

- Identifikuar, minimizuar dhe parandaluar ndikimet në mjedis
- Integruar masat mjedisore në fazën e projektimit
- Menaxhuar mbeturinat, ndotjen akustike, mbrojtjen e peizazhit dhe ndotjen e ujërave
- Dokumentuar dhe gjurmuar përputhshmërinë ligjore

-Kriter për projekte publike, ndërkombëtare dhe të financuara nga donatorë

- EIB, WBIF, BERZH dhe BE **kërkojnë ISO 14001 ose ekuivalent** për subjektet kontraktuese të angazhuara në projekte që kanë ndikim të ndjeshëm mjedisor.
- Është kusht për **kualifikimin** në shumë procedura konkurruese të nivelit të lartë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- *N.P-1 – B Punime gjurmimi në tokë*
- *N.P-2 – A Ndërtime civile dhe industrial*
- *N.P-4 – G Rrugë, autostrada, hekurudha, tramvaj, metro*
- *N.P-5 – F Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti*
- *N.P – 7- A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje*
- *N.P – 11-C Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë*
- *N.P-12 – D Punime të inxhinierisë së mjedisit*
- *N.S-1 -B Punime për prishjen e ndërtimeve*
- *N.S - 2- A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavaxteri, mirëmbajtja e tyre*
- *N.S – 3 – A Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)*
- *N.S-4 – A Punime rifiniture të natyrës ndërtuese*
- *N.S – 6-A Sinjalistika rrugore jondriçuese*
- *N.S-7 – A Barriera dhe mbrojtje rrugore*
- *N.S-8 –A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike*
- *N.S-9 –F Punime strukturore special*
- *N.S-11 –D Punime mbi shina dhe traversa*
- *N.S-13 –B Impiante dhe linja telefonike/telekomunikacioni*
- *N.S-14 –A Impiante të brendshme, elektrike, telefonike, alarm, TV*

- N.S-18 – D Punime topogjeodezike
- N.S-19 –A Sisteme kundra zhurmës për infrastrukturë
- N.S – 20-A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria ekërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve qëparashikohen të kryhen në preventiv,që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P-1 – B	Punime gjërmimi në tokë	(tek preventivi PERMANENT WAY, 2.Earthworks me vlere mbi 20 milion)	21-50 mln lek
N.P-2 – A	Ndërtime civile dhe industrial	(strehet e dy ndalesave apo stacioneve, por që nuk kanë nje ze te vecante ne preventive)	0-20 mln lek

<i>N.P-4 – G</i>	<i>Rrugë, autostrada, hekurudha, tramvaj, metro</i>	(ketu futet vlere e plote e gjithë preventivit pasi ka te beje me detyren kryeore te projektit)	Mbi 800 mln lek
<i>N.P-5 – F</i>	<i>Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti</i>	(tek preventivi BRIDGES, OVERPASSES dhe UNDERPASS me vlere mbi 40milion)	401-800 mln lek
<i>N.P – 7- A</i>	<i>Ujësjetllës, gazsjellës, vajsjetllës, vepra kullimi e vaditje</i>	(tek preventivi PERMANENT WAY, 1. Preparatory duhet te kete spostime te rrjetit te ujesjetllësit se jemi ne zone urbane)	0-20 mln lek
<i>N.P – 11-C</i>	<i>Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë</i>	(tek preventivi ELECTRIFICATION me vlere mbi 50 milion)	51-100 mln lek
<i>N.P-12 – D</i>	<i>Punime të inxhinierisë së mjedisit</i>	(tek preventivi me vlere mbi 100 milion)	101-200 mln lek
Punime speciale ndertimi			
<i>N.S-1 -B</i>	<i>Punime për prishjen e ndërtimeve</i>	(tek preventivi PERMANENT WAY, 1. Preparatory works me vlere mbi 20milion)	21-50 mln lek
<i>N.S - 2- A</i>	<i>Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavaxteri, mirëmbajtja e tyre</i>	(nuk kan nje ze te vecante ne preventive por jane banjot e stacioneve, normalisht duhet te kete)	0-20 mln lek
<i>N.S – 3 – A</i>	<i>Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)</i>	(tek preventivi 3. OVERPASSES 4.1 Lifting elevators and accessories)	0-20 mln lek
<i>N.S-4 – A</i>	<i>Punime rifiniture të natyrës ndërtuese</i>	(strehet e dy ndalesave apo stacioneve, por qe nuk kan nje ze te vecante ne preventive)	0-20 mln lek
<i>N.S – 6-A</i>	<i>Sinjalistika rrugore jondriçuese</i>	(tek preventivi PERMANENT WAY, Road works)	0-20 mln lek
<i>N.S-7 – A</i>	<i>Barriera dhe mbrojtje rrugore</i>	(rrethimi I hekurudhes dhe ndonje barrier per rruget prane)	0-20 mln lek
<i>N.S-8 –A</i>	<i>Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike</i>	(tek preventivi 3. OVERPASSES mbikalim metalik)	0-20 mln lek
<i>N.S-9 –F</i>	<i>Punime strukturore special</i>	(eshte konsideruar nenkalimi I ri qe do behet poshte bulevardit, tek preventivi UNDERPASS, me vlere mbi 400milion)	401-800 mln lek
<i>N.S-11 –D</i>	<i>Punime mbi shina dhe</i>	(tek preventivi PERMANENT WAY,	101-200 mln lek

	<i>traversa</i>	3. Rails, 4. Sleepers, 5. Turnouts, 7. Construction of CWR track line me vlere mbi 100milion)	
<i>N.S-13 –B</i>	<i>Impiante dhe linja telefonike/telekomunikacioni</i>	(tek preventivi TELECOMUNICATION me vlere mbi 20 milion)	21-50 mln lek
<i>N.S-14 –A</i>	<i>Impiante të brendshme, elektrike, telefonike, alarm, TV</i>	(është konsideruar ndricimi I stacioneve, kamerat e sigurise, TV per info per udhetaret etj)	0-20 mln lek
<i>N.S-18 – D</i>	<i>Punime topogjeodezike</i>	((tek preventivi me vlere mbi 100 milion)	101-200 mln lek
<i>N.S-19 –A</i>	<i>Sisteme kundra zhurmës për infrastructure</i>	(mqqs jemi ne zone urbane duhen marre masa nga projekti final, kunder zhurmave)	0-20 mln lek
<i>N.S – 20-A</i>	<i>Shpime gjeologjike, inxhinierike, puse e shpime për ujë</i>	. (shpime gjeologjike merret 2% e preventivit total, pra ka vlere mbi 20 milion)	0-20 mln lek

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. *Inxhinier Ndërtimi*
- b. *Inxhinier Transporti*
- c. *Inxhinier Mekanik*
- d. *Inxhinier Elektrik*
- e. *Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik*
- f. *Inxhinier Mjedisi*
- g. *Inxhinier Hidroteknik*
- h. *Inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshaidet*

Në rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Për këtë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- kontratë individuale pune të vlefshme,*
- diplomë përkatëse,*
- librezë pune*

-si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri. Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi

Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknik të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paastësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

a. Inxhinier Ndërtimi

- Projektton dhe dimensionon strukturat (beton, çelik, themele)
- Siguron që objekti të jetë i **qëndrueshëm dhe i sigurt**
- Kontrollon përputhshmërinë me **normat teknike dhe sizmike**
- Është baza kryesore e projektit konstruktiv

b. Inxhinier Transporti

- Analizon qarkullimin dhe aksesin rrugor
- Projektton rrugë, kryqëzime, hyrje-dalje
- Siguron **lëvizshmëri të sigurt dhe funksionale**
- Parandalon bllokime dhe rreziqe trafiku

c. Inxhinier Mekanik

- Projektton sistemet HVAC (ngrohje, ftohje, ventilim)
- Sisteme kundër zjarrit dhe pajisje mekanike
- Siguron **komoditet dhe funksionim teknik të objektit**
- Rrit eficiencën energjetike

d. Inxhinier Elektrik

- Projektton furnizimin me energji elektrike
- Ndriçimi, tokëzimi, mbrojtja nga mbingarkesat
- Siguron **siguri elektrike dhe funksionalitet**
- I domosdoshëm për çdo objekt modern

e. Inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik

- Studion tokën dhe nëntokën
- Jep rekomandime për themelet
- Parandalon rrëshqitje, fundosje dhe dëmtime strukturore
- Thelbësor për **sigurinë afatgjatë të ndërtimit**

f. Inxhinier Mjedisi

- Vlerëson ndikimin në mjedis
- Menaxhimi i ujërave, mbetjeve dhe ndotjes
- Siguron përputhje me ligjet mjedisore

- Ndhmon në zhvillim të qëndrueshëm

h. Inxhinier Hidroteknik

- Projektton furnizimin me ujë dhe kanalizimet
- Menaxhimi i ujërave të shiut dhe përmytjeve
- Siguron higjienë dhe funksionim normal
- Parandalon dëmtime nga uji

i. Inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshaider

- Kryen matje të sakta të terrenit
- Përcakton kufijtë e pronës dhe kuotat
- Bazë për të gjitha projektimet e tjera
- Siguron saktësi në zbatim dhe dokumentacion

Shenim: Bazuar ne Rekomandimin Nr.6732, date 21.10.2020 "Mbi problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP", inxhinierët e mësipërm duhet te vetdeklarojne se ata jane te disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate

2.3.7 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin teknik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 4 (katër) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 2 (dy) Inxhinier Topograf / Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

Për këtë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

-kontratë individuale pune të vlefshme,

-diplomë përkatëse,

-librezë pune

-si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri. Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të

parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe të nenit 39, pika 6, shkronja “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë personelin e nevojshëm dhe të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin teknik dhe mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve të parashikuara, duke qenë proporcional me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës.

Nevoja për përfshirjen e inxhinierëve përkatës në zbatim është e diktuar si nga përvoja praktike, ashtu edhe nga legjislacioni në fuqi për punimet e ndërtimit. Në praktikë, mungesa e stafit të specializuar teknik sjell vonesa në realizimin e punimeve, mospërmbushje të standardeve teknike dhe cenim të cilësisë së objektit.

Për këtë arsye, operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike dhe profesionale, kapacitetet organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, në mënyrë që të garantohet zbatimi korrekt, cilësor dhe në afat i kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, konkretisht:

- a. 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si "Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier", si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.
- b. 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

❖ Stafi i kërkuar në pikën 2.3.8 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo

furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos ne kete kontrate ku dhe numuri i punojesve te kerkuar per realizimin e saj eshte i larte. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.”

Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave

Prania e një (1) punonjësi të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” është e domosdoshme për të garantuar reagim të menjëhershëm dhe të kualifikuar në rast aksidentesh ose situatash emergjente gjatë zbatimit të projektit. Ky punonjës kontribuon në minimizimin e rrezikut për jetën dhe shëndetin e punonjësve, në menaxhimin efikas

të emergjencave deri në mbërritjen e shërbimeve përkatëse, si dhe në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe standardeve të sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtoare minimalisht 60 (gjashtedhjetë) persona. në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet. *Stafi i sipërcituar të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.* Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit të fuqi (nëpërmjet formës elektronike). *Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.*

Argumentim: *Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

*Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtoare të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **të paktën 110 persona**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtnuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtnuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te percaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas perqindjes se bashkepunimit.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e percakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku percaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”. Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.*

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasi
1	Eskavator ≥ 30 ton	Pronësi ose me qira	2 cope
2	Eskavator ≥ 20 ton	Pronësi ose me qira	1 cope
3	Minieskavator	Pronësi ose me qira	1 cope
4	Buldozer	Pronësi ose me qira	1 cope
5	Fadromë	Pronësi ose me qira	1 cope
6	Greider	Pronësi ose me qira	1 cope
7	Kamion vetëshkarkues me kapacitet ≥ 20 ton	Pronësi ose me qira	8 cope
8	Kamion me vinç	Pronësi ose me qira	1 cope
9	Kamionçinë	Pronësi ose me qira	2 cope
10	Autovinç me kapacitet mbajtes ≥ 70 ton	Pronësi ose me qira	1 cope
11	Autobot uji	Pronësi ose me qira	1 cope
12	Rrul vibrues hekur-hekur	Pronësi ose me qira	1 cope
13	Rrul vibrues hekur-gomë	Pronësi ose me qira	1 cope
14	Kompaktor (plate/trench compactor)	Pronësi ose me qira	1 cope
15	Sondë për shpim pilotash	Pronësi ose me qira	1 cope
16	Autobetoniere	Pronësi ose me qira	8 copë
17	Autopompë betoni	Pronësi ose me qira	2 copë
18	Vibrator betoni thellësie	Pronësi ose me qira	3 copë
19	Vibrator betoni i sipërfaqësor	Pronësi ose me qira	2 copë
20	Motopompë uji	Pronësi ose me qira	2 copë
21	Motogjenerator	Pronësi ose me qira	1 copë
22	Skeleri	Pronësi ose me qira	300m ²
23	Kallëpe të ripërdorshme	Pronësi ose me qira	600 m ²
24	Frezë asfalti	Pronësi ose me qira	1 copë
25	GPS/GNSS/Total station	Pronësi ose me qira	1 copë
26	Makineri tampimi <i>për ballastin</i>	Pronësi ose me qira	1 copë
27	Makineri rregullatore ballasti	Pronësi ose me qira	1 copë
28	Pajisje prerje & saldim shina	Pronësi ose me qira	1 copë
29	Asfaltoshtruese	Pronësi ose me qira	1 copë
30	Autobitumatriçe	Pronësi ose me qira	1 copë
31	Fabrikë Betoni (e paisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
32	Fabrikë asfalti (e paisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1

33	Nyje Inerte (e paisur me leje mjedisore kodë III.1.B	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
----	--	---	--------

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- *Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).*
- *Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës dhe objekti.*
- *Per mjetet e marra me qira qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Per te gjithë mjetet dhe paisjet e kerkuara te shoqerohen me foto.*

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “d”., të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.*

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:

- a. Certifikatë: ISO 9001/2015 -*Sistemi i Menaxhimit të cilësisë*, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Certifikatë: ISO 45001 : 2018 - *Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes*, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. Certifikatë: ISO 14001:2015-“*Sistemet e menaxhimit te ambientit*” e vlefshme, ose ekuivalente

Argumentimi:

a. Certifikatë ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Zbatimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas standardit ISO 9001:2015 është i domosdoshëm për të garantuar organizim, kontroll dhe përmirësim të vazhdueshëm të proceseve gjatë realizimit të projektit. Ky standard siguron cilësi të qëndrueshme në projektim dhe zbatim, rrit besueshmërinë e shërbimeve të ofruara dhe garanton përputhshmëri me kërkesat teknike, kontraktuale dhe ligjore në fuqi.

b. Certifikatë ISO 45001:2018 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Zbatimi i standardit ISO 45001:2018 është i nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve gjatë zhvillimit të aktivitetit ndërtimor. Ky sistem kontribuon në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve profesionale, parandalimin e aksidenteve dhe krijimin e një mjedisi pune të sigurt, duke garantuar përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë në punë.

c. Certifikatë ISO 14001:2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor

Zbatimi i standardit ISO 14001:2015 është i domosdoshëm për menaxhimin e ndikimeve mjedisore që rrjedhin nga aktivitetet e projektit. Ky sistem siguron kontroll të ndotjes, menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtje të mjedisit, si dhe garanton përputhshmëri me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe politikat e zhvillimit të qëndrueshëm.

